Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/607
Datë: 13.10.2023

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 05.10.2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet dhe validohet** Shkolla e Mesme e Mjekësisë "Alma Mater Europaea Campus Colege Rezonanca & Poliklinika Rezonanca" sh.p.k me adresë: Magjistralja Prishtinë-Ferizaj km.10, Fsh. Konjuh, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 05.10.2023 deri 04.10.2026, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK):

   1.1 Teknik i Laboratorit Mjekësor, Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar i kombinuar (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me dy (2) klasë/paralele brenda vitit, me nga njëzet e pesë (25) nxënës në një klasë/paralele si dhe me nga dy (2) grupe për praktikë. Në total për një vit mund të regjistrojë 50 nxënës.

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Shkolla e Mesme e Mjekësisë "Alma Mater Europaea Campus Colege Rezonanca & Poliklinika Rezonanca" sh.p.k ka parashtruar në AKK kërkesë për akreditim dhe validim për kualifikimin Teknik i Laboratorit Mjekësor. AKK bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka zhvilluar procedurat për vlerësim të institucionit sa i përket plotësimit të kritereve të përcaktuara nga AKK.
Pas realizimit të vizitës në këtë institucion nga ekipi i ekspertëve dhe trajtimit në detaje të dokumentacionit, ekipi i ekspertëve në raportin përfundimtar të hartuar me datë 28.08.2023 ka dhënë vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e vetëvlerësimit; Vizitën e ekipit të ekspertëve në Shkollën e Mesme të Mjekësisë "Alma Mater Europaea Campus Colege Rezonanca & Poliklinika Rezonanca" sh.p.k si dhe dokumente tjera shtesë.

Andaj, në bazë të kërkesës së Shkollës së Mesme të Mjekësisë "Alma Mater Europaea Campus Colege Rezonanca & Poliklinika Rezonanca" sh.p.k për akreditim dhe validim si dhe rekomandimeve përfundimtare të ekipit të ekspertëve të dhëna në Raportin e vlerësimit për akreditim dhe validim për institucionin aplikues, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Shkollës së Mesme të Mjekësisë "Alma Mater Europaea Campus Colege Rezonanca & Poliklinika Rezonanca" sh.p.k.

2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim MUSTAFA

Kryetar i KD të AKK-së